



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**  
**Nr. 19, datë 10.03.2014**

**PËR**  
**MARRJEN E MASAVE KORRIGJUESE NDAJ BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 13, 14, pika 23, dhe nenit 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E :**

Në zbatim të programit të inspektimit nr.3338 prot, datë 08.11.2013 dhe nr. 3338/1 prot, datë 26.11.2013, AMF ushtroi inspektim në vend pranë BSHS-së. Nga ky inspektim është konstatuar se:

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve me Vendimin nr. 134, datë 01.11.2012, ka vendosur që të gjitha shoqëritë e sigurimit të ndjekin praktikat gjyqësore ku Byroja është palë e paditur, si dhe të padive të regresit. Ky vendim nuk po gjen zbatim nga disa shoqëri sigurimi.

Byroja Shqiptare e Sigurimit, trajton praktikat e dëmeve që rrjedhin nga policat kufitare, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 112, datë 05.06.2012.

Kjo procedurë është në kundërshtim me kompetencat e BSHS-së, të parashikuara në nenet 42 e vijues, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

BSHS konfirmon se lidhur me dëme të trajtuara nga korrespondentët, nuk disponon informacion për datën e pagesës së dëmeve të trajtuara prej tyre (si nga shoqëritë e sigurimit, apo korrespondenti Imperial Claims Services–Albania) në favor të palës së tretë dhe vlerës përkatëse, siç përcaktohet në kërkesat e nenit 6, pika 2 të Rregullores nr. 21, datë 19.03.2010.

BSHS ka filluar procedurat e inventarizimit të policave të sigurimit - model i vjetër, për të 3 produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik , proces i cili nuk ka përfunduar akoma.

Byroja Shqiptare e Sigurimit është vënë në dijeni të shkeljeve të konstatuara nga raporti përfundimtar i inspektimit.

**Për sa më sipër, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, referuar situatës së Byrosë Shqiptare të Sigurimit, lidhur me performancën e saj dhe domosdoshmërinë për ndjekjen e problemeve që lidhen me funksionet e Byrosë,**

### **V E N D O S I:**

1. Bazuar në nenin 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” urdhërohet Byroja Shqiptare e Sigurimit:

- Të procedojë me përzgjedhjen e kandidaturës për funksionin e Drejtorit ekzekutiv të BSHS-së, referuar kërkesave të Këshillit të Byrove Bruksel dhe statutit të BSHS-së, me qëllim miratimin paraprak nga Autoriteti, konform dispozitave të pikës 2 të nenit 43, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”;
- Të ndërpresë trajtimin e praktikave të dëmeve që rrjedhin nga polica kufitare, në kundërshtim me kompetencat e BSHS-së, konform dispozitave të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009;
- Të rishikojë statutin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit për ndarjen e qartë të kompetencave të organeve drejtuese të BSHS-së;
- Të marrë masa për ndjekjen e procedurave për rimbursimin nga personat përgjegjës për dëmet objekt i Fondit të Kompensimit;
- Të kërkojë nga korrespondentët raportim periodik lidhur me datën e pagesës së dëmit në favor të palës së tretë dhe vlerën përkatëse, sipas kërkesave të nenit 6, pika 2, të Rregullores nr. 21, datë 19.03.2010;
- Të përfundojë menjëherë procesin e inventarizimit të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik-model i vjetër.

2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**  
**Enkeleda SHEHI**

**Në mungesë dhe me porosi,**

**Enkela IDRIZI**  
**NËNKRYETAR**